

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

GËZIM ALIU

RRËFIMI PËR TOTALITARIZMIN - ROMANI KONCERT NË FUND TË DIMRIT

Pas romanit “Kush e solli Doruntinën”¹, ku e trajton Besën dhe shpreh admirimin për shoqërinë pa pushtet shtetëror, Kadare u kthehet mekanizmave të shtetit. Mekanizmave të shtetit komunist totalitar, që është edhe pjesa thelbësore e romanit “Koncert në fund të dimrit”², pra pjesa ku autori i nënkuptuar, duke përdorur narratorin, paraqet mekanizmat e funksionimit të shtetit totalitar, për ç’gjë do të flasim te pjesa e analizimit të shmangieve nga doktrina. Kadare, në këtë roman merret me dy shtete komuniste, Shqipërinë e vogël e Kinën e madhe dhe marrëdhëniet e prishjen që ndodh mes tyre. Ky roman është zgjatim tematik i “Dimrit...”³ sovjetik dhe stina e dimrit, bashkë me ftohtësinë, ende ka mbetur në titujt (edhe pse dimri kinez është shumë më i lehtë se ai sovjetik, i stolisur madje edhe me humor të hollë).⁴

Romani “Koncert në fund të dimrit” fillon në një ambient familjar, po si te romani sivëlla më i madh. (Familja komuniste e shëndoshë është, po si te “Dimri...”, vendi kryesor i fillimit, zhvillimit dhe degëzimit të ngjarjeve). Edhe stili i rrëfimit, shumë linja që gërshetohen, narratori që futet edhe në skutat më të errëta të “ndërgjegjes njerëzore” (të karaktereve), tema e prishjes me një aleat të madh, udhëtimi i zyrtarëve atje (veçse kësaj radhe pa heroin, Enver Hoxhën) dhe me një nuancim mjaft interesant (sidomos udhëtimi i shkrimtarit Bermema, bashkë me dorëshkrimet e tij), tallja me burokracinë, ngjajnë shumë me romanin “Dimri i vetmisë së madhe”. Për këtë shkak edhe këto dy romane janë quajtur diptik. Tema e trajtuar, prishja me Kinën e largët të Mao Ce Dunit, këtë roman e mban brenda doktrinës, për shkak se fillimisht merret me aktualitetin, e si rrjedhojë autorit i duhet që domosdoshmërisht qëndrimi ndaj aktualitetit të tillë politik të mos e kapërcejë qëndrimin zyrtar. Shqipëria e Enver Hoxhës, sipas versionit zyrtar, që prishur me Kinën për çështje parimore ideologjike (e shkas ishte vizita e Niksonit në Kinë). Kështu, prapë, po si në konfliktin me sovjetikët, shqiptarët janë ata që kanë të drejtë, ndërkaj miku i djeshëm i madh, sot demonizohet. Shqipëria e vogël edhe njëherë del mbrojtëse e parimeve marksiste-

¹ I. Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

² I. Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

³ I. Kadare, *Dimri i vetmisë së madhe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1973.

⁴ “Me “Koncert në fund të dimrit” I. Kadare ka rekuizuar shumë elemente të romanit epike. Këtë nuk e synon me volum të faqeve, por me zgjerim dhe thellim të dimensioneve realiste. Ky roman, ashtu si dhe “Dimri i madh” e japin botën e sotme në kompleksitetin që ka. Shtetet, kombet, klasat, partitë, madje individët ndërvaren nga rrethana të brendshme dhe botërore...” (A. Kallulli, *Dukuri realiste dhe novatore të romanit tonë*, në “Nëntori”, nr. 2, 1990, f. 5).

leniniste. Në krye të kësaj Shqipërie është Enver Hoxha, figura pozitive e “Dimrit...”. Veçse kësaj radhe, kjo figurë shfaqet vetëm kah fundi, i rehatuar në një shtëpi pushimi, duke medituar dhe duke lexuar shënimet e tij për Kinën. Ai është lideri i pamëshirshëm parimor marksist-leninist i Shqipërisë komuniste dhe i asgjëson edhe miqtë e tij të deridjeshëm për ta ruajtur partinë dhe komunizmin e pastër shqiptar!

Fillimisht ta shohim ecjen e romanit me doktrinën e realizmit socialist:

- Qëndrimi për prishjen me Kinën është në vijë me qëndrimin zyrtar;
- Trajtimi i kinezëve dhe Kinës;
- Prania e Enver Hoxhës ndihet që nga fillimi, por ai shfaqet kah fundi, figurë që e shpëton Shqipërinë nga Kina dhe komplotistët;
- Denigrimi i mëtutjeshëm i ish-borgjezëve;
- Cili realitet?;

1. Kadare e shkruan “Koncertin...” disa vite pas prishjes me Kinën, por e boton vetëm në vitin 1988. Sidoqoftë, qëndrimi autorial ndaj kësaj ngjarjeje politike dhe shoqërore ishte sikur i pushtetit dhe, duhet thënë: si mund të ishte ndryshe! Ndonëse nuk thuhet askund drejtpërdrejt, del mendimi autorial se kjo miqësi nuk ishte e natyrshme, prandaj edhe i kishte ardhur fundi. Megjithatë, zyrtarisht, prishja me Kinën e madhe që bërë për shkaqe parimore, më saktë, sipas qëndrimit zyrtar, afrimi i kinezëve me Amerikën ishte i pamundur të miratohej nga komunistët. Enver Hoxha, shefi i Shqipërisë ia dërgon një letër të hidhur liderit të Kinës, që gjendet në një shpellë, i veçuar nga njerëzimi, ku nuk pranonte asgjë, pos rasteve të jashtëzakonshme. Dhe, autori i nënkuptuar që në këtë pjesën e ecjes në vijë me doktrinën është përfaqësues i autorit real, por edhe i qëndrimit zyrtar, letrën e Hoxhës e bën të tillë:

Midis baltës dhe gurëve të shpellës u shfaq letra e huaj, që iu duk armiqësore. Sikur të mos ishte prej së shoqes, ai nuk do ta hapte kurrë... Ajo i shkruante për ngjarjet e fundit në kryeqytet, për sëmundjen e Çu En Lait, në fund shtonte se shefi i Shqipërisë kishte dërguar një letër...

Grua mendjelehtë, tha me vete duke i hequr sytë prej hieroglifëve. Ke dëgjuar ndonjëherë që letrat të dërgohen nën dhe?

...
Kaq herë ju kam thënë se ndër gjërat që urrej më tepër kur jam këtu, janë letrat...

Shefi i Shqipërisë pra i kishte dërguar një letër. Hm. Një letër zyrtare ku nuk i uronte asgjë... Ku përkundrazi i shkruante diçka të keqe, shumë të keqe...

Hieroglifet e fundit ishin edhe më të hidhurat. Shqipëria ishte kundër vizitës së ardhshme të presidentit të SHBA në Kinë dhe pothuajse haptas kërkonte anulimin e saj. (f. 31)

Se a i ka shkruar Maos letra e Hoxhës deri në shpellën e tij të veçimit, nuk është aq me rëndësi për letërsinë, mirëpo, këta rreshta që cituam e tregojnë qëndrimin zyrtar të Shqipërisë ndaj vizitës së “superfuqisë imperialiste”, SHBA-së, në Kinë dhe, po ashtu, e shfaqin edhe pajtimin autorial me këtë gjë. Si? Autori i nënkuptuar e bën aq të rëndësishme një letër nga Shqipëria e vogël sa për t’ia

Rrëfimi për totalitarizmin - romani *Koncert në fund të dimrit*

prishur qetësinë meditative shpellare liderit të një populli njëmiliardësh! Mao Ce Duni tërbohohet fare nga kjo letër:

... *Do të bëj hatanë, tha ai me vete. Do t'i jap Shqipërisë një mësim që të dridhet një mijë vjet më vonë, kur ta kujtojë. Do të luaj me të si macja me miun.* (f. 34)

"Komploti" që rrjedh më pas në Shqipëri, me të cilin do të merremi me të pak më poshtë, është pasojë e këtij tërbimi. Natyrisht, Enver Hoxha e zbulon komplotin dhe e shuan pa mëshirë.

2. Janë nga dy-tri vende ku autori i nënkuptuar shpreh respekt për kinezët dhe Kinën përgjithësisht, por në këtë roman, trajtimi i kinezëve dhe Kinës nga ai, e ndërton figurën kolektive të antagonistit (Shqipëria është protagonist, David, kurse Kina është Goliati, dhe i pari fiton, si zakonisht; janë disa goliati të shtrirë përtokë në prozën e Kadaresë, nisur qysh nga "Gjenerali...") dhe njëfarë demonizimi dhe talljeje me ta mbisundon, ndonëse në mënyrë mjaft perfide e finoke.⁵ Por, kështu del qartë ideja se shqiptarët nuk duhej të miqësoheshin aq ngushtë me një komb dhe kulturë të ndryshme, të largët, antagoniste edhe pse gjatë periudhës së kësaj miqësie fatkeqe, Shqipëria kishte pranuar ndihma të mëdha nga Kina.⁶ (Mirëpo, nuk del ideja se me kë duhej miqësuar Shqipëria komuniste pas kësaj ngjarjeje politike; duhej qëndruar "kështjellë"? Mbase, kushedi! Pas prishjes me Kinën, Shqipëria edhe kishte mbetur një kështjellë e varfër, e izoluar, e bllokuar nga vetvetja, në brigjet e bukura të Adriatikut e Jonit). Është interesante që përshkrimi grotesk i kinezëve dhe Kinës komuniste përgjithësisht nuk mund të zgjojë asociacione të analogjisë me jetën komuniste shqiptare të pranishme në roman, pasi, atje, në Kinë, revolucioni kulturor, sipas autorit (real e të nënkuptuar), kishte çoroditur bazat e mënyrës së jetesës njerëzore, prandaj, mesazhi i tij është se një gjë e tillë nuk duhej provuar në Shqipëri.⁷ Mirëpo, kështu krijohet përshtypja që në Shqipëri jetohej mirë, meqë revolucioni kulturor nuk ishte mbjellë aty. A ishte ky realiteti? Do të flasim pak më poshtë për këtë, por të qëndrojmë te çështja për të cilën po flasim. Krahasinim që del vetvetiu

⁵ Një gjë e tillë nuk shfaqet te "Dimri...". Madje, në atë roman, tonet janë mjaft dramatike dhe serioze, po ashtu edhe respekti ndaj mikut të djeshëm e armikut që po ngrihej në horizont si kërcënim, Bashkimit Sovjetik. Kjo mbase ndodh shkaku i pranisë ushtarake sovjetike në Pasha Liman. Kërcënim të tillë nga Kina nuk kishte, pos shfryrjeve imagjinare të Maos në shpellë.

⁶ Shih J. S. O'Donnell, *A Coming of Age, Albania Under Enver Hoxha*, East European Monographs, Boulder, Distributed by Columbia University Press, New York, 1999, f. 77, ku jepen të dhëna se ndihma kineze ndaj Shqipërisë, gjatë kohës së raporteve shumë miqësore, ishte dhjetë miliardë *yuan Renminbi* ose përafërsisht pesë miliardë dollarë.

⁷ Ta përkujtojmë personazhin shkrimtar e kritik me emrin përqeshës C.V., bashkudhëtar i Skënder Bermemës në vizitën e shkrimtarëve atje, me rastin e ditës së zogjve, pasi nuk kishte ditë tjetër më letrare për t'u festuar, për shkak se Lidhja e Shkrimtarëve në Kinë ishte shuar. Ky C.V., duke u mbështetur në përvojën kineze, kërkonte që edhe në Shqipëri të mos viheshin emrat e shkrimtarëve në librat autorialë, pasi gjithçka i takonte masës, popullit, kolektivizimit. Kadare tallet fort me këtë tip të ngazëllyer me revolucionin kinez dhe e quan me atë emër që dihet çfarë përkujton.

mes jetës shqiptare dhe asaj kineze, autori e përdor për ta paraqitur dallimin thelbësor mes tyre dhe për ta motivuar demonizimin dhe talljen me shfjytyrimin që kishin pësuar kinezët si rrjedhojë e masave shtrënguese të udhëheqësisë komuniste kineze ndaj popullit të shtypur. Demonizimi nis qysh në fillim të romanit, me paraqitjen e Mao Ce Dunit si një përbindësh, i tërhequr në shpellë, teksa mbi sipërfaqen e saj kishte krijuar fusha të paanë marihuane, përmes së cilës synonte drogimin e Evropës dhe shpëlarjen e trurit të botës. Me shtetin që udhëhiqej nga një lider i tillë nuk duhej shoqëruar, por pasi që miqësia kishte ngjarë, ishte zhvilluar dhe kishte pasur edhe të mirat e saj, “prishja e qetë” (f. 50) që po niste, duhej arsyetuar disi, si strategji prapavajtëse. Ndër arsyetimet letrare që lexojmë në këtë roman se shkaku që po prisheshin me Kinën, përveç çështjeve ideologjike, ishte edhe papërshtatshmëria kulturore e shoqërore me kinezët. Thjesht, ata nuk ishin të përshtatshëm për miq aq të ngushtë. Krijohet atmosfera përligjëse përgjatë tërë romanit për këtë prishje të domosdoshme dhe nxjerrjen e Shqipërisë si palë që ka të drejtë. Këtu mund ta përmendim edhe një motiv të vogël, por ilustrues, që e përshkon romanin: aksidenti qesharak me kinezin Ping që e akuzon Viktor Hilën se ia kishte shkelur këmbën dhe çështja merr përmasa ndërshtetërore, pasi kinezët e bëjnë të tillë, kurse Hila e pëson me transferim nga puna. Po ashtu, përveç të deklasuave (e çuditshme kjo!), të gjithë personazhet e tjerë e dëshirojnë “çlirimin” nga kinezët, edhe pse e dinë se kjo do të thoshte masa pasuese shtrënguese. Kështu, demonizimi dhe tallja me kinezët është në vijë me qëndrimin edhe zyrtar. Simbolike në tërë këtë atmosferë, aty kah fundi i romanit, është shkatërrimi i fishekzjarrëve kinezë natën nga punëtorët e komunaes dhe heqja e pjesës së antenës që rrok valët e agjencisë kineze të lajmeve Hsinhua. Shqipëria po ndahej nga një aleat i panatyrshëm. Ky është mesazhi i autorit. Mesazh që shkon në vijë me retorikën e shtetit.

Prandaj, paraqitja e tillë e ish-mikut nga autori nuk është asgjë më shumë se paraqitja e tillë e ish-mikut nga shteti komunist shqiptar më pastaj.

3. Kush e shpëton Shqipërinë nga një përbindësh si Mao dhe nga një shtet si Kina? Natyrisht që Enver Hoxha, prania e të cilit ndihet që nga fillimi, por i cili shfaqet shkurtimisht aty kah fundi i romanit. Enver Hoxha edhe njëherë shfaqet shpëtimtar!

Në fillim të romanit, udhëtari zyrtar Gjergj Dibra e dërgon një letër në Kinë. Ai, personazhi, nuk e di se çfarë letre është ajo. Por, narratori ynë i gjithëdijshëm, që ‘sundohet’ mirë nga autori i nënkuptuar, e di. Është një letër e Enver Hoxhës për Mao Ce Dunin. Kjo letër arrin deri në shpellën e vetëngujimit të Maos, madje shkakton tronditje të atillë sa që ky i fundit tërbohet krejt. Liderit të popullit më të madh të planetit i shkakton kesi tërbimi Enver Hoxha, lideri i shtetit të vogël komunist.

Në një darkë te një ministër (që më vonë do të trajtohet si komplotist naiv), cingëron telefoni. Ministri zverdhet nga fjalët e dikujt në anën tjetër. Është Enver Hoxha. Kjo merret vesh më vonë. Hoxha del mbrojtës i paepur i partisë, të cilën komplotistët ushtarakë dëshirojnë ta rrënojnë.

Rrëfimi për totalitarizmin - romani *Koncert në fund të dimrit*

Dy herët e para vetëm ndihet prania e fuqishme e “frymës” së liderit të fortë, heroit të mbledhjes së tetëdhjetë e një partive në Moskë, më 1960, ku kishte shfaqur një guxim pothuajse të krisur ballkanasi. Heroi shfaqet prapë, por kësaj radhe shumë më pak dramatik.

Herën e tretë, në romanin “Koncerti...”, nga prania jo e drejtpërdrejtë, Enver Hoxha shfaqet “fizikisht” në një vilë pushimi pranë detit, duke lexuar shënimet për Kinën e duke medituuar për këtë shtet, miqësinë me të, kombinatin metalurgjik që rrezikonte të bllokohej (kinezët ishin sabotatorët e supozuar), luftën, brezat e partisë. Ja çfarë mendon lideri i madh i shtetit të vogël komunist:

Ai vështroi prapë bregun e detit, si për të shpërndarë atje pjesën e keqe të lajmit të porsamarrë (shpërthimi në kombinat, ku kishte mbetur një i vrarë v.ime). Po a fronte mbarimi i mijëvjeçarit dhe vendi duhej të ndante llogaritë me një botë që ai s’e kishte dashur kurrë. Kishte bërë çmos që Shqipëria të gdhinte në mijëvjeçarin e tretë me atë fytyrë që kishte moduluar ai. Por duhej të bënte akoma që kjo pamje të ishte e përrjetshme dhe të mos ndërrohej dot nga askush. (f. 532)

Nga një vizion i tillë historik e ideologjik, me fytyrë vendi të moduluar nga një njeri si ai, autori e shpie heroin te motivi që do të duhej të merrej si pengesë në rrugëtimin e Shqipërisë drejt të ardhmes:

Tani do të dilnin me dhjetëra, si në kohën e prishjes me sovjetikët, që ndarjen me Kinën do ta merrnin si ndarje me komunizmin ose lindjen, siç thoshnin në Perëndim. Do të prisnin hapjen e kishave, liberalizimin e jetës, të gjitha ato që andej quheshin “hapje ndaj botës”.

Do të gëzoheshin para kohe njëlloj si atëherë.... Dhe njëlloj si atëherë ai do të godiste pa mëshirë. (f. 532)

Asgjë nuk do ta ndryshojë kursin komunist të Shqipërisë. As kursin izolues. Çfarë qëndrimi mban autori? Si gjithëherë në prozën e Kadaresë, ambivalenca kuptimore mbisundon. Këto radhë mund t’i interpretojmë si skalitje të një lideri të fortë pozitiv që drejton mirë vendin, por edhe si skalitje të një diktatori që shuan çdo shpresë për hapjen e Shqipërisë ndaj botës.

Simptomatike për këtë dykuptimësi është skena pasuese. Ministri D., komplotisti, gjendet në burg. Më vonë do të merremi pakës me këtë karakter, por qenësorja këtu është se ai ishte “zbuluar” e burgosur me akuzën e komplotit ndaj partisë dhe shtetit. Paraqitja e karakterit të këtij komplotisti të supozuar është në vijë me qëndrimin zyrtar. Loja autoriale me dykuptimësinë bëhet edhe më e turbullt. Ishte autori për mbajtjen e Shqipërisë “kështjellë”, ashtu siç e modulonte Enver Hoxha? Nganjëherë, kryesisht për shkaqe të presionit, vepra e tij e lë këtë përshtypje! Megjithatë, vetë përmendja e hapjes është guxim autorial, në anën tjetër, prandaj nuk do të vazhdojmë edhe më tutje me spekulime.

4. Të deklasuarit. Te analiza tekstuale e ideore që i kemi bërë romanit “Dimri i vetmisë së madhe”, kemi argumentuar me citime të shumta paraqitjen negative që autori i bën klasës së rrëzuar, të deklasuarve pra, ish-borgjezëve të kohës së Mbretërisë. Edhe në romanin “Koncert në fund të dimrit” vazhdon i njëjti trajtim,

ndonëse më i lehtë.⁸ Sikur që ishin rehatuar familjet komuniste në jetën e përditshme mjaft të mirë, edhe të deklasuarit ishin rehatuar disi. Gjendemi në familjet e njëjta, por kësaj radhe, narratori më shumë e përcjell një të deklasuar, Ekrem Fortuzin, që mëson gjuhën kineze për të mundur të marrë dokumente e materiale për të përkthyer e për të marrë ndonjë lekë më shumë. Kur po afronte koha e ndarjes përfundimtare me Kinën, të gjithë gëzoheshin, kurse vetëm të deklasuarit shpresonin se kjo nuk do të ndodhte. Ata, çuditërisht e shohin shpëtimin te Mao (shih f. 291). Tjetër aspekt i paraqitjes së tyre denigruese është edhe jeta intime e të deklasuarve: e fejuara e Markut i kërkon këtij të fundit t'i tregojë për aktin seksual që kishte pasur me Zanën, kurse e shoqja e Ekremit i kërkon këtij që teksa bëjnë dashuri t'i flasë në italishte e jo kineze. Sa për krahësim, dashuria e komunistëve, e Gjergj Dibrës me të shoqen, Silvën, është plot ndjenja e mall. Për më tepër, në vazhden e paraqitjes jo fort të mirë të të deklasuarve, autori na e krijon edhe një tip skizofreni ish-borgjez, ish-pronar i fabrikës së sapunëve, i cili ende mendon se është i tillë, madje në çantën e vet mban shënime për përparimet që po ndodhnin në fabrikë, flet për planet trevjeçare e pesëvjeçare, kurse pak më vonë e var vete. Po sikurse vdekja e plakës Nurihan te "Dimri...", edhe këtu e kemi një vdekje ish-borgjezi, kësaj radhe mjaft mizore.

5. Nëse ishte ky realiteti i klasës së përmbysur (sigurisht ka qenë shumë më i rëndë) dhe meqë po flasim për një vepër të shkruar në kohën kur kërkohej realizëm e socializëm në letërsi, atëherë e shtrojmë pyetjen krejtësisht kontekstuale: Cili realitet? Cilin realitet mund ta hetojmë përmes këtij romani?

Romani nis në një familje komuniste, të zyrtarëve shtetërorë; Gjergj Dibra punon në ministrinë e Jashtme, e shoqja në ministrinë e Ndërtimit; natyrisht që këta kanë një rrjet miqsh, përmes të cilëve ndërtohet edhe pjesa më tërheqëse e romanit, raportet mes tyre, aferat e motrës së Silvës, Anës së ndjerë, lidhjet e saj (së pari Frederiku, pastaj shkrimtari interesant, një si alter-ego e autorit, Skënder Bermema, më tutje burri i dytë, Besnik Struga i mbledhjes së Moskës), shkukurëzimet, skandalet; por edhe lidhjet e aferat e të tjerëve (intimiteti është mjaft i pranishëm në këtë roman) etj. Të gjitha këto japin detaje të jetës kryeqytetase mjaft të konsoliduar. Kjo vërehet madje edhe te drekat e darkat që shtrojnë, kafet që pinë, bisedat që bëjnë. Gjithçka duket normale.⁹ E konsoliduar.

⁸ "Do të dukej sikur "Koncerti" nuk do të ishte i plotë, në qoftë se në skenën e tij nuk do t'u ishte lënë vendi i merituar edhe përfaqësuesve të klasave të përmbysura në vendin tonë. Nga vatha e tyre autori ka krijuar një varg tipash në veprat e mëparshme, prandaj ata nuk do të mungonin edhe këtu. Por paraqitja e tyre në këtë roman ka veçorinë e vet. Ata nuk parashikojnë masakra si shoferi i kamionçinës së mishit te "Dimri", janë disi "të urtësuar" dhe të rrëguar nga shoqëria e sotme..." (Kritiku i realizmit socialist ia lëvdon romanit këtë motivin e denigrimit të mëtutjeshëm të klasës së përmbysur; shih Tefik Çausi, "Gjëmimi i një koncerti – vështrim estetik mbi romanin e Ismail Kadaresë *Koncert në fund të dimrit*, në revistën "Nëntori", nr. 12, 1988, f. 12).

⁹ "Shoqëria shqiptare dhe kineze janë dy hemisfera të ndryshme të globit të veprës. Përballë jetës kineze që po çhumanizohet me anë të ekstremizmave pseudorevolucionare, vihet jeta shqiptare: e thjeshtë, e zakonshme, njerëzore, prandaj edhe e bukur, bile edhe me

Rrëfimi për totalitarizmin - romani *Koncert në fund të dimrit*

Veç një detaj e prish këtë idil dhe autori këtu e shpreh perfiditetin e vet të përjetshëm: ndihet kudo një frikë. Kjo shprehet haptas kah fundi i romanit, kur një personazh i çuditshëm, Simon Dersha, shkruan autokritikë pa ia kërkuar askush, për darkën te Ministri D., ku një telefonatë e Hoxhës e kishte nisur rrënimin e ministrit të fuqishëm. Edhe njëherë autori luan me dykuptimësinë. Paraqitja e jetës kryeqytetase lë përshtypjen e një jete normale me të gjitha të mirat dhe të këqijat, sfidat e telashet që mund t'i ketë jeta (po flasim për jetën brenda botës së fiksonit që ka referencë jetën jashtë tij). Nën këtë vel normaliteti, syri i mprehtë i lexuesit e vëren frikën që mbizotëron në brendi të njerëzve. Frika i shtyn njerëzit të bëjnë autokritikë, por, mbase e njëjta i motivon për t'u bërë anëtarë partie, si shefi i Silvës në zyrën e saj, i cili është i mërziur që nuk është anëtar partie.

Sidoqoftë, loja me dykuptimësinë nuk "reflekton" realitetin. Po të shkruante autori për realitetin e vërtetë, dhe jo këtë të parë me syze të kontrolluara nga partia e pushteti, ai sigurisht që do të përfundonte në burg.

Më lart i pamë motivet që e bëjnë romanin respektues të doktrinės. Por, me çka realizohet shmangia më e madhe e këtij romani? Me rrëfimin për totalitarizmin! Janë disa motive që lidhen në temën e totalitarizmit:

-*Mao Ce Duni dhe komploti i vrasjes së Lin Biaos;*

-*Ministri D.;*

-*Arrestimi i Arian Krasniqit;*

-*Parodizimi i "Njeriut të ri";*

-*Motivi i mikrofonave dhe përgjimit;*

-*Simon Dersha dhe çështja e autokritikave përgjithësisht.*

Por, fillimisht të ndalemi pakës se puna e totalitarizmit. A është Kadare shkrimtar antitotalitar?¹⁰ Kadare jetonte në një shtet diktatorial dhe botonte shumë vepra përmes organeve botuese të këtij shteti. Ishte edhe personalitet shumë i rëndësishëm, jo vetëm i letrave, por edhe i kulturës përgjithësisht. Nisur nga këto fakte kontekstuale, ky autor nuk mund të cilësohet shkrimtar antitotalitar, as disident, gjë që edhe vetë ky shkrimtar e pohon më vonë. Kadare, edhe me veprat e tij nuk del i tillë: në disa nga veprat e tij kemi rrëfim për shoqëritë totalitare, por nuk kemi qëndrim autorial të qartë kundër totalitarizmit. I tillë është edhe rasti me romanin "Koncert në fund të dimrit". Edhe motivet e lartpërmendura që i etiketua si shmangie nga doktrina janë të këtij niveli: rrëfim për totalitarizmin,

përshkrimin e hollësishëm të punëve të shtëpisë. Po ashtu, mbyllet me një intimitet dhe ngrohtësi familjare, ndërkohë që romani është thellësisht politik, me probleme të mëdha politiko-shoqërore e ideologjike..." (B. Kuçuku, *Sintezë e fuqishme e dy realiteteve të kundërta*, në revistën "Nëntori", nr. 4, mars, 1988, f. 24-25).

¹⁰ Në një studim timin të mëhershëm, ndër elementet e veprës së tij, kam përmendur edhe antitotalitarizmin. Sigurisht që ishte cilësim i shpejtë, duke u mbështetur në romanin *Pallati i ëndrrave*, botuar pas rënies së diktaturës. Zanafillësi i këtij romani, noveleta *Nëpunësi i pallatit të ëndrrave* që botuar së pari herë më 1980. Shih G. Aliu, *Diskurset e ideve në prozën e Kadaresë*, Faik Konica, Prishtinë, 2007.

por jo qëndrim autorial kundër. Po të kishte qëndrim të tillë të qartë, dihet se si do të përfundonin punët për shkrimtarin.

Rrëfimi dhe përshkrimi i sistemit totalitar në disa romane të këtij autori, siç e theksuam, është vetvetiu lëvizje në binarin e shmangies nga doktrina e realizmit socialist, sepse na jep informacione “të brendshme” për shoqëritë totalitare komuniste, të majta: Shqipërinë, Bashkimin Sovjetik, Kinën. Një antitotalitarizëm finok mund të nxirret pos nëse pjesë të caktuara të romanit “Koncert në fund të dimrit” shkoqen nga teksti i tërësishëm. Posa të kthehen këto pjesë në tërësinë e tekstit, antitotalitarizmi i supozuar shuhet, kurse mbetet rrëfimi dhe përshkrimi i “gjendjes në terren”. Shembulli më i mirë të ky roman është fati i personazhit Arian Krasniqi, oficer tankist që arrestohet e burgoset për mosbindje ndaj Ministrit D., i cili kishte urdhëruar rrethimin me tanke të një komiteti partie. Ndonëse mosbindja është e dënueshme me ligje, urdhri ishte i dënueshëm nga “mekanizmat popullorë”, për të cilët flet Enver Hoxha në plenum: askush nuk guxon ta prekë partinë, madje as për lojë. Prandaj, burgosja e oficerit përfundon mirë dhe drejtësia e partisë vihet të vend. Çka mund të nxjerrim nga kjo? Mund ta shkoqim nga tërësia e tekstit pjesën ku rrëfëhet për arrestimet e burgosjet dhe pasojat që mund t’i kishin edhe familjarët “e njollosur” nga veprimi i familjarit të tyre, gjë kjo e vërtetë në atë sistem. Mirëpo, kjo shkoqje teksti nuk mjafton që autorin ta cilësojmë si antitotalitar, sepse ky, ndonëse me mungesë fryme patetike, e thekson çështjen e drejtësisë së partisë, që qëndron madje edhe mbi ligjet e shkruara, është si instancë fetare, përmbi aferat njerëzore, prandaj edhe e paprekshme. Pra, mund të flasim për devijim nga doktrina e realizmit socialist, por jo për antitotalitarizëm. I tillë është edhe rasti i karakterit të nënshtruar tërësisht ndaj sistemit totalitar, nëpunësit Simon Dershës, që shkruan autokritikë pa ia kërkuar kush. Rrëfimi për një karakter të frikësuar deri në palcë nuk është automatikisht antitotalitarizëm. Është thjesht informacion për frikën e ankthin e njerëzve që jetonin nën diktaturën komuniste.

Të kthehemi te motivet përmes të cilave autori rrëfen për sistemin totalitar, në të cilin jetonte edhe vet. Duhet thënë se prania kaq e madhe e motiveve që lidhen me totalitarizmin, edhe pse nuk paraqet antitotalitarizëm, shpreh guximin autorial të nivelit të lartë. Dy vjet e pak ditë pas botimit të këtij romani, sistemi totalitar në Shqipëri shembet.

1. Mao Ce Duni dhe Lin Biao. Rrëfimi për vrasjen e Lin Biaos, ushtarakut të lartë të regjimit dhe mikut personal të liderit të Kinës, Maos, është qartë tregim për mënyrën e funksionimit të diktaturës në aparatin qendror të udhëheqjes. Vrasjet e kundërshtarëve politikë, lufta për pushtet, krimet e tmerrshme për ta mbajtur pushtetin, intrigat, komplotet, këto ishin stolitë e zëza të mbajtjes gjallë të shtetit totalitar. Demokracia popullore, në të cilën thirreshin, ishte një shaka e errët. Nuk kishte as demokraci, as të drejta të njeriut, as liri të shprehjes, madje kishte edhe mungesa të ushqimit, pasi, populli, sa më i lodhur, aq më mirë për aparatin udhëheqës. Ndër taktikat për mbajtjen e frikës e terrorit në popull dhe sundimin e tij më të lehtë, ishin edhe intrigat e vrasjet e brendshme. E tillë është edhe vdekja misterioze e mareshalit Lin Biao, zyrtarisht i rrëzuar me aeroplan diku në

shkretëtirat e Mongolisë, në përpjekje për të ikur nga Mao, pasi ky i fundit gjoja e kishte zbuluar komplotin e mareshalit për rrëzimin e tij. Dyshimet për vdekjen e tij misterioze, autori i nënkuptuar na i jep përmes shkrimeve të personazhit shkrimtar, Skënder Bermemës.

“E vërteta për vdekjen e Lin Biaos”, Synopsis, është tekst për të vërtetën e vdekjes së mareshalit. Duke e kthyer mbrapsht historinë e Makbethit, personazhi shkrimtar, S. Bermema rrëfen për intrigën e vrasjes së Lin Biaos dhe hamendëson për mundësitë se si mund të ishte eliminuar ai. Sinopsisi shtrihet nga faqja 440 deri në faqen 449, me nëntë mundësi vrasjeje. Por, kryesorja, boshti i ngjarjes është se Lin Biao ishte ftuar në darkë dhe pas mbarimit të saj, disa kilometra më tutje në rrugë, ishte qëlluar me raketë, trupi i karbonizuar ishte zhvendosur në një avion, e ky i fundit ishte rrëzuar në shkretëtirat e Mongolisë. Ndonëse e vërteta e plotë nuk dihej, hamendësohej se në vija të trasha kështu kishte ndodhur eliminimi.

Ishte ora dhjetë e mbrëmjes, kur Maoja me të shoqen dhe Çu En Lai i përcollën mysafirët gjer te porta e vilës. Natën e mirë, mirupafshim. Ndonjë natë mirë se të vini edhe ju. Patjetër, patjetër...

Vetura e zezë, e blinduar, e mareshalit rrëshqiti në xhadenë e errët. Grupi i vogël i përcjellësve qëndroi në këmbë me shikimin andej nga ikën mysafirët. Ata qëndruan kështu pothuajse të heshtur, gjer në kohën që u dëgjua një gjëmim.

Maoja mori frymë thellë. Me hollësisir merruni ju, iu drejtua Çu En Lait dhe së shoqes dhe u fut i pari në vilë. (f. 440)

Pas këtyre fjalive, narratori autorial merret me hamendësime se si kishte rrjedhur aksioni. Në fund e lexojmë këtë paragraf:

... Në këtë histori askush nuk e ka ditur gjer në fund të vërtetën. Duhej të ishte në mendjet e secilit, të Maos e të mareshalit, madje, në mendjet e të dyve njëkohësisht, për të shpjeguar ndoshta atë që ndodhi. (f. 449)

2. Në krahasim me historinë mes Maos dhe Biaos, të mbushur me mister e turbullirë, historia mes Enver Hoxhës dhe Ministrit D., pra ministrit të Mbrojtjes, gjeneralit të famshëm Beqir Balluku, nuk ka asnjë mister brenda vetes. Ministri, sipas versionit zyrtar, të cilit nuk i shmanget as autori, po përgatitej të komplotonte kundër partisë (Hoxhës pra) me mbështetjen e kinezëve me të cilët Shqipëria po prishej, ishte zbuluar dhe kishte marrë fund. Simptomatike janë ngjashmëritë mes liderit dhe ushtarakut, miq të luftës dhe ideologjikë, si në historinë paraprake kineze, si në historinë shqiptare. Miqtë e luftës e të sundimit totalitar në fund i ndan vdekja, veçse, në këtë rast, e shkaktuar nga të parët, për të mbajtur pushtetin (Mao), dhe për ta ruajtur partinë (Hoxha), kështu që motivi i Makbethit kthehet kokëposhtë në të dyja rastet. Natyrisht që për historinë e dytë, Hoxha-Balluku Kadare nuk guxon të shfaqë hamendësime si për historinë e parë, por ngjashmëritë e përmendura më sipër, e tregojnë qartë intencën autoriale.

3. Arrestimi i oficerit tankist, Arian Krasniqi. Historia e oficerit tankist, në tërësinë e saj, nuk është shmangie nga doktrina, siç tashmë e pohuam pakës me lart. Në fund të kësaj historie, drejtësia e palëkundshme e partisë vihet në vend, Ariani lirohet, kurse Ministri D., burgoset. Mirëpo, shkoqja e një pjese tekst, pra, e

një pjese histori, e qet autorin në binarin e shmangies. Përmes kësaj shkoqjeje tekstuale, ne lexojmë për frikën e arrestimeve dhe burgosjeve, si dhe frikën për pasojat që një gjë e tillë mund të kishte për familjarët e të burgosurit, pasi, një i tillë (politik, kuptohet kjo), ishte “i njollosur” dhe me njollën e vet nxinte gjithçka përreth, më së shumti familjen:

Ra zilja e telefonit, që e bëri Silvën të dridhet. Gjergji ngriti dorezën e telefonit dhe që në fjalët e para Silva e kuptoi se telefonimi s'ishte për atë që i shko i mendja asaj. Ndërsa Gjergji i përgjigjej dikujt, ajo mendonte se do të vinte ndoshta dita që do t'u duhej t'i rrallonin, në mos t'i ndërprisnin fare telefonimet dhe vizitat në shtëpinë e vëllait. Dhe kjo s'ishte ende gjithçka. Mund të ndodhte që Sonja (Sonja është grua e Arianit. v.ime) të ndahej prej tij, në qoftë se burgimi do të ishte i gjatë. Kishte raste që jo vetëm gratë, por gjithë farefisi zhbëheshin me të dënuarin. (f. 166)

Mjaft hapur rrëfëhet për këtë çështje, apo jo? Këto mund t'i pësonin madje edhe familjet e etabluara komuniste:

... familja jonë... ti e kupton, Sonja. Në rrethin tonë shumica e njerëzve janë komunistë, në punë të rëndësishme... S'është njëlloj si në një familje të deklasuarish.

Silva po bëhej nervoze ngaqë i dukej se sa më shumë fliste, aq më tepër e humbte besimin. Ja, tani sapo kishte thënë ca budallallëqe për familjen, duke e kuptuar se asgjë nga ato nuk qëndronte, sepse një arrestim në një familje komunistësh s'është aspak më i lehtë se në një familje të deklasuarish, përkundrazi, duke qenë i pazakontë, ishte më serioz... (f. 163-164)

4. Ardha e komunizmit në skenën botërore, pra edhe në Shqipëri, u pasua, pas konsolidimit të pushtetit totalitar, edhe me një inxhiniering social. Qytetet e fshatrat ndryshoheshin, tokat kolektivizoheshin, artet e kultura ishin bërë mjete propagandistike, ndryshonte gjithçka sipas planeve të byrove politike të zbatuara pa asnjë këshillim me popullin, dhe ironia ishte se gjithçka bëhej në emër të tij. Për hir të një të ardhmeje utopike, bëhej gjithçka që komunizmi, nga teoria të bëhej edhe praktikë. Dihet se praktika, pas disa dekadash eksperimentim, kishte dështuar, duke marrë me vete miliona viktima dhe duke bërë ndryshime dramatike në jetët e njerëzve dhe popujve. Perandoria e kuqe komuniste, që sundonte gati gjysmën e botës, i kishte shkaktuar vuajtje të papërshkrueshme njeriut.

Koncepti religjioz e politik-ideologjik i “Njeriut të ri”, nga komunizmi çohet në një nivel të mëtutjeshëm: ky do të ishte “njeriu i ri komunist”, që do ta popullonte “botën e re”, pasi të shkatërrohej plotësisht bota e vjetër.¹¹ (Shkatërrimin pothuajse të plotë të ‘botës së vjetër’ e kishte arritur në vendin e vet, Kamboxhë, vetëm Pol Poti; disa milionë njerëz qenë vrarë në këtë eksperiment).

Pikërisht “njeriun e ri”, produktin final të teorisë dhe praktikës komuniste e parodizon Ismail Kadare. Këtë e bën përmes sinopsiseve të shkrimtarit Skënder Bermema, që i lexojmë teksa ai gjendet në Kinë për vizitë, me rastin e ditës së zogjve, meqë ditë tjetër nuk kishte mbetur për t'u festuar nga shkrimtarët kinezë pas zhbërjes së lidhjes së tyre.

¹¹ Shih për më tepër për këtë koncept sipas ideologjisë komuniste: Y. Cheng, *Creating the “New Man”*, From Enligntement Ideals to Socialist Realities, University of Hawai'i Press, Honolulu, 2009.

Rrëfimi për totalitarizmin - romani *Koncert në fund të dimrit*

“Komisioni për krijimin e Lej Fenit”¹², Synopsis për tregim, është rrëfim për një komision të ngarkuar për ta krijuar njeriun e ri. Këtë njeri të ri, të cilin e kërkonte Mao, kur të krijohej, duhej ta merrnin shembull të gjithë kinezët, madje të gjithë maoistët në botë. Personazhit të cilit narratori i rri afër, është kryetari i komisionit. Mbledhjet janë të pafund, pasi duhej sqaruar secilin detaj të krijesës së re. Por, mbizotëron thelbi që duhej dhënë atij, e që ishte:

Heroi ynë do të jetë i thjeshtë... I thjeshtë gjer në mohim të vetvetes, gjer në shndërrim në hije, zaten ky dhe do të jetë thelbi i tij: një hije, një refleks, një vidhë e mendimit të Mao Ce Dunit... (f. 322)

Ky është “njeriu i ri”, pra, një jo-njeri! Këtë e di edhe kryetari i komisionit, i ngarkuar për krijimin e tij. Kur më në fund e krijojnë, ai shfren:

Përbindësh, gulçonte me vete, tek po kërkonte me sy shpinën e korrierit, që tashmë s’dukej më. Përbindësh i mbyllur në dosje, murtajë, tani s’të pengon gjë të sëmurësh Kinën. (f. 327)

Koncepti i “njeriut të ri” komunist e kishte sëmurë, diku më pak e diku më shumë, pothuajse gjysmën e botës.

5. Motivi i mikrofonave. Përgjimi në shoqëritë totalitare ishte gjë normale. Përdorej nga regjimet e tilla për të mbajtur nën kontroll gjithçka dhe për të ruajtur pushtetin me çdo kusht. Përgjimi masiv i gjithkujt nuk ishte më çështje ligjore e mbrojtjes së rendit dhe ligjit. Jo! Ishte çështje politike. Më herët, motivin e përgjimit, por të mbuluar me metaforën e ëndrrës, Kadare e kishte trajtuar në novelletën “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”.¹³ Në romanin që e kemi nën shqyrtim, motivi i përgjimit nuk është fare metaforik, i fshehur pas metaforës së ëndrrës. “Seancë spiritizmi në qytetin N.” Synopsis për një novelë,¹⁴ është tregim fare i hapur për këtë motiv. Përmes autorit të nënkuptuar, në roman na bëhet e qartë se përgjimi në shtetin totalitar ishte futur gjithkund, deri te varri.¹⁵ Mikrofonat (çjetinçitë) vendosen kudo, sepse lideri i madh komunist:

...Kryetari Mao, timonieri ynë, dëshiron këndeje e tutje që të ketë informacion të saktë, të drejtpërdrejtë, të papërcudnuar prej askujt, nga gjithë Kina jonë e madhe. Dhe prandaj nëpër të gjithë Kinën e madhe që sot e tutje ai do të shpërndajë e do të

¹² **Lei Feng** (1940 –1962) ishte ushtar i Armatës Çlirimtare të Kinës. Pas vdekjes së tij, Lei ishte karakterizuar si person modest e vetëmohues, i devotshëm ndaj Partisë Komuniste, udhëheqësit Mao Ce Dun dhe popullit të Kinës. Më 1963, pas vdekjes, ai u bë subjekt i kampanjës propagandistike “Silluni sipas shembullit të Lei Feng-ut”. Lei ishte portretuar si qytetar model dhe masat kurajoheshin të garonin me vetëmohimin e tij, modestinë dhe devotshmërinë ndaj Maos. Pas vdekjes së Maos, Lei Feng-u mbeti ikonë kulturore që paraqiste zellin dhe shërbimin; emri i tij u fut në ligjërimin e përditshëm, kurse imazhi i tij paraqitej në bluza dhe përkujtimore.

¹³ I. Kadare, *Nëpunësi i pallatit të ëndrrave* në përmbledhjen me novela *Gjakftohtësia*, Naim Frashëri, Tiranë, 1980.

¹⁴ Ky synopsis, më vonë qe shkëputur nga *Koncerti...* dhe qe pavarësuar në roman, të titulluar *Spiritus*.

¹⁵ Zhvarrimi i Van Meit, pjesëmarrësit në seancën e spiritizmit; incizimi i mikrofonit, pas disa zhurmave, jep qetësinë e varrit (f. 365-369).

mbjellë këto... Këta mikrofona që kemi mbjellë sot në këto arka, janë veshët e tij... (f. 334)

Kështu u thotë i dërguari i qendrës, i Zyrës së Përgjithshme të Komitetit Qendror, apo *Çunanhait*, zyrtarëve të Drejtorisë së Sigurimit Publik të qytetit N.

Fjala “sigurim” (Drejtoria e **Sigurimit** Publik) ta përkujton Sigurimin famëkeq shqiptar, kurse qyteti (i paemër) N., gjendet në disa vepra të Kadaresë si vend zhvillimi i ngjarjeve! Analogjia e Kinës me Shqipërinë është e qartë. Kurse, përgjimi në Shqipërinë e vogël ishte edhe më i lehtë se në Kinën e madhe.

6. Simon Dersha dhe çështja e autokritikave. Autokritikat në shtetet totalitare ishin një mjet politik për poshtërimin e njerëzve. Për thyerjen e tyre. Për mbajtjen e frikës dhe kontrollit. Autokritikë kishte bërë edhe vetë Ismail Kadare.¹⁶

Por, puna e karakterit Dersha është edhe më e thellë. Mysafir në një darkë te Ministri D., krejtësisht anonim për kreun e partisë, pra të shtetit, i cili gjatë asaj darke e kishte bërë telefonatën fatkeqe, nga një njeri që shpreson se njohja e tij me ministrin do ta përparojë në pozita më të mira, ai, relativisht shpejt çrregullohet krejt nga frika dhe shkruan autokritikë pa ia kërkuar kush. Do të thotë që frika e mbjellë (kujto përdorimin e fjalën “mbjellje” te sinopsisi për ‘çjetinçitë’) në popull jepte rezultate edhe kur nuk kërkoheshin, aq e madhe ishte. Përveç autokritikave të pjesëtarëve të njësisë së tankistëve, autokritikë shkruan edhe Ministri D., që deri dje ishte njeri me pushtet të madh. Vetëm udhëheqësi, mbrojtësi i partisë, është i paprekshëm.

BIBLIOGRAFI

- A. Kallulli, *Dukuri realiste dhe novatore të romanit tonë*, në “Nëntori”, nr. 2, 1990.
 B. Kuçuku, *Sintezë e fuqishme e dy realiteteve të kundërta*, në revistën “Nëntori”, nr. 4, 1988.
 G. Aliu, *Diskurset e ideve në prozën e Kadaresë*, Faik Konica, Prishtinë, 2007.
 I. Kadare, “Dimri i vetmisë së madhe”, Naim Frashëri, Tiranë, 1973.
 I. Kadare, “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave” në përmbledhjen me novela “Gjakftohtësia”,
 I. Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
 I. Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
 J. S. O’Donnell, *A Coming of Age, Albania Under Enver Hoxha*, East European Monographs, Boulder, Distributed by Columbia University Press, New York, 1999.
 N. Frashëri, Tiranë, 1980.
 Sh. Sinani, *Letërsia në totalitarizëm dhe “Dossier K”*, Naimi, Tiranë, 2011.
 T. Çausi, *Gjëmimi i një koncerti - vështrim estetik mbi romanin e Ismail Kadaresë “Koncert në fund të dimrit”*, në revistën “Nëntori”, nr. 12, 1988.
 Y. Cheng, *Creating dhe “New Man”, From Enlightenment Ideals to Socialist Realities*, University of Hawai’i Press, Honolulu, 2009.

¹⁶ Shih Shaban Sinani, *Letërsia në totalitarizëm dhe “Dossier K”*, Naimi, Tiranë, 2011, f. 282-290.